

VENDIM
Nr. 123, datë 11.2.2015

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.7, DATË 4.1.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVEDHE
DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR ARKËTIMIN E TAKSËS SË RENTËS
MINERARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 3, të vendimit nr.7, datë 4.1.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në varësi të përqindjes së mineralit të shitur brenda vendit, nga nxjerrësi i mineralit te përpunuesi/pasuruesi i mineralit, llogaritja e pagesës së rentës bëhet sipas çmimeve, të përcaktuara në tabelat referuese, të miratuara nga komisioni *ad-hoc*, i përcaktuar në këtë vendim.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama